



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

RREGULLORE
PËR PROCEDUREN E KANDIDIMIT DHE MËNYREN E ZGJEDHJES SË
ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS MJEKËSORE TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS

Prishtinë

Në bazë të nenit 46 të ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe nenit 18, 19.2 të Statutit të përkohshëm të odës mjekësore të Kosovës, Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë pas konsultimit me këshillin për përgatitjen dhe konstituimin e odës mjekësore miraton këtë:

RREGULLORE

PËR PROCEDURËN E KANDIDIMIT DHE MËNYRËN E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS MJEKËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e kandidimit, e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të organeve të Odës Mjekësore të Kosovës: Kuvendit, Kryetarit të Odës, Këshillit Drejtues, Këshillit mbikëqyrës për buxhet dhe financa, Këshillit etikë, Gjyqi i Nderit, Prokurorit të Odës, dhe Komisioneve të tjera të përhershme.

ORGANET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Neni 2

1. Organet për zbatimin e zgjedhjeve për organet e odës mjekësore të Kosovës janë:
 - 1.1. Komisioni Qendror Zgjedhorë dhe,
 - 1.2. Komisionet e njësisive zgjedhore.
2. Komisioni Qendror Zgjedhorë ka 5 anëtarë dhe 5 zëvendës anëtarë të emëruar nga ministri i shëndetësisë.
3. Anëtarët e Komisionit të njësisive zgjedhore i emëron Komisioni Qendrorë Zgjedhorë në bazë të propozimit të njësisë zgjedhore.
4. Anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhorë dhe Komisioneve të njësisive zgjedhore emërohen më së voni 30 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Odës.

Neni 3

1. Ministria e Shëndetësisë siguron mjetet e nevojshme për zbatimin e zgjedhjeve të destinuara për:

- 1.1. Kompensim të anëtarëve të komisioneve zgjedhore;
- 1.2. Shpenzimet e informimit publikë;
- 1.3. Angazhim të personave tjerë për nevojat e procesit zgjedhorë;
- 1.4. Shtypjen e materialit zgjedhorë;
- 1.5. Sigurimin e materialit zgjedhorë dhe materialeve tjera shpenzuese;
- 1.6. Pajisjet dhe mjetet e nevojshme teknike për zbatimin e zgjedhjeve;
- 1.7. Shpenzimet e rrugës, posttelekumunikacionit;
- 1.8. Shpenzimet tjera logjistike, etj.

II. PROCEDURA E KANDIDIMIT DHE ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS MJEKËSORE

I. ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË ODËS MJEKËSORE

Neni 4

Këshilli për përgatitjen dhe konstituimin e odës mjekësore në koordinim me ministrin e shëndetësisë do të marrin vendim për shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e odës mjekësore të Kosovës së paku 60 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 5

Komisioni Qendrorë Zgjedhor i odës mjekësore të Kosovës, në bashkëpunim me komisionet zgjedhore të njësisive zgjedhore duhet ti kryejë të gjitha veprimet dhe përgatitjet për mbajtjen e zgjedhjeve.

Neni 6

1. Të gjithë mjekët dhe anëtarët e odës zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e odës me votim të drejtpërdrejtë në njësitë zgjedhore të përcaktuara nga komisioni qendrorë zgjedhorë sipas këtyre parimeve:

- 1.1. Anëtarët e Kuvendit të OMK zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë në njësitë zgjedhore të përcaktuara nga komisioni qendrorë zgjedhor i odës mjekësore.
- 1.2. Institucionet publike shëndetësore të nivelit parësorë në çdo 50 anëtarë të regjistruara zgjedhin një anëtarë për kuvendin e odës mjekësore.

- 1.3. Institucionet publike shëndetësore të nivelit dytësorë në çdo 35 anëtar të regjistruara zgjedhin një anëtarë për Kuvendin e Odës Mjekësore.
 - 1.4. Institucionet publike të nivelit tretësorë në çdo 25 anëtarë të regjistruara zgjedhin një anëtarë për kuvendin e odës mjekësore.
 - 1.5. Institucionet Private Shëndetësore të organizuara në asociacionin profesional të IPSH-se delegojnë 10 anëtarë në Kuvendin e Odës Mjekësore.
 - 1.6. Institucionet e mbrojtjes sociale, shërbimit korrektues të Kosovës, FSK-se dhe ShPK-ja delegojnë nga një anëtarë në Kuvendin e Odës Mjekësore.
 - 1.7. Mjekët nga Diaspora të organizuar përmes shoqatave profesionale delegojnë 5 anëtarë në Kuvendin e OMK.
 - 1.8. Shoqatat e Psikologeve të licencuar klinik delegojnë 7 anëtarë në Kuvendin e Odës Mjekësore.
2. Me qëllim të formimit më të lehtë të njësisë zgjedhore shmangiet nga kriteret e numrit të mjekëve të regjistruar në institucionet publike dhe private mund të jenë $\pm 5 \%$

Neni 7

Me qëllim të formimit më të lehtë të njësisë zgjedhore shmangiet nga kriteret e numrit të mjekëve të regjistruar në institucionet publike dhe private mund të jenë $\pm 5 \%$

Procedura e kandidimit

Neni 8

1. Për anëtarë të odës mjekësore mund të propozohet dhe zgjidhet çdo anëtarë i regjistruar dhe licencuar në bordin për licencim.
2. Kandidatin për anëtarë të odës mund ta propozojë çdo anëtarë i odës i regjistruar në regjistrin e anëtarëve të odës.

Neni 9

Secila kandidaturë për anëtarë të odës mjekësore duhet të mbështetet me nënshkrimet e së paku 5 anëtarëve të odës mjekësore, të njësisë zgjedhore.

Neni 10

Pas përfundimit të procedurës së kandidimit komisioni qendrorë zgjedhore përcakton listën përfundimtare të kandidatëve sipas njësisive zgjedhore dhe i publikon në faqen zyrtare të MSh, dhe në të gjitha njësitë zgjedhore.

Neni 11

1. Zgjedhjet për anëtarë të kuvendit të odës mjekësore mbahen në njësitë zgjedhore.
2. Secili vend-votim ka numrin e vetë rendorë.

Neni 12

Komisioni Qendrorë Zgjedhorë ka për obligim që me kohë të përgatitë dhe të distribuon ter materialin zgjedhorë duke përfshirë fletëvotimet, ekstraktin e votuesve për secilën njësi zgjedhore, dhe vendvotimi, fletëvotimet, procesverbalet dhe shkresat tjera.

Neni 13

1. Votimi është personalë dhe bëhet në fletëvotim, duke shenjzuar emrin e kandidatit.
2. Votuesi ka të drejtë të votojë vetëm për një kandidat.
3. Fletëvotimi përmban: Numrin rendorë të njësisë zgjedhore dhe emrin dhe mbiemrin të kandidatëve për secilën njësi zgjedhore të renditura sipas alfabetit.

Neni 14

Fletëvotimet e pa plotësuar, fletëvotimet në të cilat janë rumbullakuar numrat rendorë i emrave të më shumë kandidatëve se zgjidhen nga nisja zgjedhore dhe fletëvotimet ku nuk mund me saktësi të vërtetohet se për cilin kandidatë është votuar konsiderohen të pa vlefshme.

Neni 15

1. Votimi në vend votime fillon në ora 8 dhe përfundon në ora 18.
2. Në rast se në vendvotim kanë votuar të gjithë votuesit e regjistruar vendvotimi mund të mbyllet edhe para orës 18.
3. Gjatë tërë kohës së votimit anëtarët e komisioneve zgjedhore të njësisive zgjedhore duhet të jenë prezentë dhe të kujdesen për mbajtjen e rendit në hapësirën ku mbahet votimi.

Neni 16

Secili votues duhet të identifikohet nga komisioni zgjedhorë i njësisë zgjedhore duke prezantuar kartën identifikuese, apo dëshmi tjera të pranueshme me të cilat vërtetohet, autenticiteti i votueseve.

Përcaktimi dhe shpallja e rezultateve të votimit

Neni 17

1. Pas përfundimit të afatit për votim komisioni zgjedhorë i njësisë zgjedhore, përcakton rezultatet e zgjedhjeve në njësinë zgjedhore.
2. Paraprakisht në bazë të regjistrit të votuesve përcakton numrin e përgjithshëm të votuesve që kanë votuar dhe pastaj bën hapjen e kutisë të cilat i krahason me numrin e pa përdorur të fletëvotimeve dhe konstaton numrin e saktë të votuesve.
3. Pas përfundimit të numërimit komisioni konstaton numrin e votave për secilin kandidatë në bazë të renditjes në fletëvotim dhe numrin e fletëvotimeve të pa vlefshme.

Neni 18

1. Komisioni Zgjedhor i njësisë zgjedhore pas numërimit të të gjitha fletëvotimeve plotëson procesverbalin i cili duhet të përmbajë: numrin e tërësishëm e votuesve sipas regjistrit të votuesve në njësinë zgjedhore, numrin e votuesve që kanë votuar, numrin e votave që ka fituar secili kandidatë sipas numrit rendorë në fletëvotim dhe numrin e fletëvotimeve të pavlefshme.
2. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisioni zgjedhorë të njësisë zgjedhore.

Neni 19

Procesverbalet së bashku me materialin tjetër zgjedhorë duhet ti dorëzohen komisionit qendrorë zgjedhorë së paku 18 orë nga mbyllja e vendvotimit.

Neni 20

1. Komisioni Qendrorë Zgjedhorë në afat prej 5 ditësh shpallë rezultatet përfundimtare për zgjedhjen e anëtarëve të odës mjekësore të Kosovës.
2. Komisionet e njësisve zgjedhore, publikojnë rezultatet preliminare zgjedhore në njësinë zgjedhore në afat prej 3 orësh, nga ora e përfundimit të procesit zgjedhor.

Neni 21

Mandati i anëtarëve të Kuvendit të odës mjekësore zgjatë 4 vite dhe fillon të rrjedhë nga dita e certifikimit të rezultateve nga kuvendi i odës mjekësore.

Anëkimimi në procesin zgjedhorë

Neni 22

1. Secili kandidatë për anëtarë të odës mund të parashtrojë ankesë nëse konsideron se ka pasur parregullsi në procesin zgjedhorë.
2. Ankesa i parashtrohet komisionit zgjedhorë të njësisë zgjedhore në afat prej 3 orësh nga publikimi rezultateve preliminare, nga komisioni qendrorë zgjedhorë i njësisë zgjedhore.
3. Komisioni zgjedhorë i njësisë zgjedhore ka për obligim që në afat prej 12 orësh nga dita e pranimit të ankesës ti kthejë përgjigjeje me shkrim ankuesit .
4. Kandidati i pakënaqur me vendimin e komisionit zgjedhorë të njësisë zgjedhore në afat prej 24 orë mund të bëjë ankesë komisionit qendrorë zgjedhorë.

Neni 23

1. Konsiderohet se anëtari i odës mjekësore është i revokuar nëse për revokimin e tij kanë votuar më shumë se gjysma e anëtarëve të odës në njësinë përkatëse zgjedhore.
2. Në rast revokimi kuvendi i odës mjekësore duhet të fillojë procedurën për zgjedhje plotësuese në njësinë përkatëse zgjedhore në afat prej 45 ditësh nga dita e votimit.

Neni 24

Anëtarit të revokuar të njësisë përkatëse zgjedhore i pushon anëtarësimi në komisionet dhe trupat e kuvendit të odës mjekësore.

II. ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE ZV. KRYETARIT TË ODËS

Neni 25

1. Secila kandidaturë për kryetarë të odës mjekësore duhet të mbështetet me nënshkrimet e së paku 20 anëtarëve të kuvendit të odës mjekësore, të njësisë zgjedhore.

2. Kandidatura në formë të shkruar i dorëzohet komisionit qendrorë zgjedhorë i cili përcakton listën përfundimtare të kandidatëve për kryetarë të odës.

Neni 26

Në afat prej 10 ditëve nga mbledhja e parë konstituive e kuvendit duhet të caktohet mbledhja e kuvendit për zgjedhjen e kryetarit të odës.

Neni 27

1. Konsiderohet se është zgjedhur kandidati i cili ka fituar më së shumti vota me kusht që për të të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve prezentë.

2. Në rast se asnjëri kandidatë nuk ka fituar mbi gjysmën e votave të anëtarëve prezentë dy kandidatë me numrin më të madh të votave do të kualifikohen për rundin e dytë të votimit.

3. Në rundin e dytë të votimit konsiderohet së është zgjedhur kandidati që ka fituar më shumë vota nga anëtarët e kuvendit.

Neni 28

Me propozim të kryetarit Kuvendi i OMK me shumicë votash zgjedhë zëvendës kryetarët e OMK.

III. ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 29

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të kuvendit të odës mjekësore bëhet zgjedhja e anëtarëve të këshillit drejtues të odës.

2. Kryetari dhe zv. Kryetarët e odës mjekësore janë anëtarë të këshillit drejtues sipas detyrës zyrtare.

3. Kandidatura për anëtarë tjerë të këshillit drejtues të odës duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit të odës mjekësore. Votimi për anëtarë të këshillit drejtues është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.

4. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

IV. ZGJEDHJA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË ODËS

Neni 30

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të kuvendit të odës mjekësore bëhet zgjedhja e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të odës.
2. Këshilli mbikëqyrës i odës ka kryetarin dhe 4 anëtarë të cilët zgjidhen nga kuvendi i odës me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë tjerë të këshillit mbikëqyrës të odës duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit të odës mjekësore.
4. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

V. ZGJEDHJA E KËSHILLIT ETIKË

Neni 31

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të kuvendit të odës mjekësore bëhet zgjedhja e anëtarëve të këshillit etikë të odës.
2. Këshilli etikë i odës ka kryetarin dhe 4 anëtarë të cilët zgjidhen nga kuvendi i odës me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë tjerë të këshillit etikë të odës duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit të odës mjekësore.
4. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

VI. ZGJEDHJA E GJYQIT TË NDERIT

Neni 32

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të kuvendit të odës mjekësore bëhet zgjedhja e anëtarëve të gjyqit të nderit të odës.
2. Gjyqi i Nderit të odës mjekësore ka 5 anëtarë, Kryetarin zv.kryetarin dhe 3 anëtarë.
3. Një (1) anëtarë i gjyqit të nderit zgjedhat nga kuvendi nga lista e propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
4. Kandidimi për kryetar të Gjyqit të Nderit duhet të mbështetet nga së paku 10 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit të odës, ndërsa për zv.kryetarin dhe dy anëtarët tjerë nga 5 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit të odës mjekësore.
5. Votimi është i drejtpërdrejtë dhe i fshehtë.

6. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

VII. ZGJEDHJA E PROKURORIT TË ODËS

Neni 33

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të kuvendit të odës mjekësore bëhet zgjedhja e anëtarëve të prokurorit të odës.
2. Prokurori dhe zv.prokurori zgjedhën nga kuvendi i odës nga radha e anëtarëve të odës në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për Prokurorë të odës duhet të mbështet nga së paku 10 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit të odës, ndërsa për zv.prokurorë nga 5 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit të odës mjekësore.
4. Votimi është i drejtpërdrejtë dhe i fshehtë.
5. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

VIII. ZGJEDHJA E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË ODËS

Neni 34

1. Komisionet e Përhershme të odës janë :
 - 1.1.Komisioni për çështje etike;
 - 1.2.Komisioni për licencim;
 - 1.3.Komisioni për edukim specialistik;
 - 1.4.Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
 - 1.5.Komisioni për praktiken private profesionale;
 - 1.6.Komisioni për buxhet dhe financa;
 - 1.7.Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke

Neni 35

1. Komisionet nga neni paraprak kanë nga 5 anëtarë nga radhët e të cilëve zgjedhet kryesuesi dhe zv kryesuesi i komisionit.

2. Kandidatura për anëtarë të komisioneve të përhershme të odës duhet të mbështet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit të odës.

Neni 36

Fushëveprimi i komisioneve të përhershme përcaktohet me akte të veçanta normative të miratuar nga kuvendi i odës.

Neni 37

Dispozitat shfuqizuese


Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja e miratuar nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë me dt.06 Korrik 2013.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 38

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë.

Prishtinë 11 tetor 2013


Ministri i Shëndetësisë
Prof. Dr. Ferid Agani